

SEKTORI REAL

Tabela nr.1 Prodhimi i Brendshëm Bruto ECC 2010

Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) i paraqitur në tabelën 2 është përgatitur nga ZShS-ja sipas metodologjisë së Sistemit Europian të Llogarive (ECC 2010).

Më shumë informacion rreth metodologjisë së krijimit të PBB-së sipas ESA2010 mund të gjeni në linkun e mëposhtëm: http://www.stat.gov.mk/Dokumenti/ESA2010_mk.pdf

Tabela nr.2 Shpenzimet jetësore - Gjithsej

Seritë totale të shpenzimeve jetësore të paraqitura në Tabelën 3 janë prodhuar nga ZShS-ja.

Më shumë informacion rreth metodologjisë së mund ta gjeni në linkun e mëposhtëm: <http://www.stat.gov.mk/ceni>

Tabela nr.3 Shpenzimet jetësore – COICOP

Burimi i të dhënave të çmimeve është ZShS-ja.

Më shumë informacion rreth metodologjisë së mund ta gjeni në linkun e mëposhtëm: <http://www.stat.gov.mk/ceni>

Tabela nr.4 Prodhim industrial

Burimi i të dhënave të çmimeve është ZShS-ja.

Më shumë informacion rreth metodologjisë së mund ta gjeni në linkun e mëposhtëm: http://www.stat.gov.mk/industrisko_proizvodstvo

Tabela nr.5 Punësimi dhe produktiviteti në të gjithë ekonominë

Burimi i të dhënave të paraqitura të punësimit është Anketa e Fuqisë Punëtore (ARS) e ZShS-së.

Më shumë informacion rreth metodologjisë së kësaj ankete mund të gjeni në linkun e mëposhtëm: http://www.stat.gov.mk/pazar_na_trud

Produktiviteti në ekonomi llogaritet në BPRMV në baza tremujore, ku produktiviteti i përgjithshëm përfaqëson shumë të ponderuar të produktivitetit të llogaritur në nivel të një sektori individual të ekonomisë. Brenda secilit sektor, produktiviteti llogaritet si raport ndërmjet vlerës së shtuar në atë sektor dhe numrit të personave të punësuar. Të dhëna për PBB-në totale dhe numrin e të punësuarve në ekonomi (sipas Anketës së Fuqisë Punëtore (ARS) e ZShS-së

Tabela nr. 6 Pagesa

Burimi i të dhënave të paraqitura për pagat e paguara neto dhe bruto për punonjës është ZShS-ja.

Më shumë informacion rreth metodologjisë së përpunimit të këtyre të dhënave mund të gjeni në lidhjen e mëposhtme: <http://www.stat.gov.mk/plati>

Tabela nr.7 Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut (Buxheti qendror dhe buxhetet e fondeve)

Burimi i të dhënave të paraqitura është Ministria e Financave të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Më shumë informacion rreth të dhënave mund të gjeni në linkun e mëposhtëm: <http://www.finance.gov.mk/mk/node/898>

Tabela nr.8 Indeksi i çmimeve të banesave

Indeksi i çmimeve të banesave është përgatitur nga BPRMV-ja për territorin e Shkupit. Indeksi është përgatitur mbi bazën e të dhënave që lidhen me shpalljet e shitjeve të publikuara nga agjencitë që merren me transaksionet e pasurive të paluajtshme. Llogaritja e indeksit bëhet me metodën hedonike dhe frekuenca e indeksit është tremujore.

Indekset hedonike të çmimeve bazohen në modelet hedonike të çmimeve, sipas të cilave çmimi i një produkti është një funksion që rezulton nga karakteristikat e tij. Çmimi i apartamentit është funksion që rezulton nga madhësia e banesës, lagjja në të cilën ndodhet, kati, nëse apartamenti ka ngrohje qendrore dhe nëse apartamenti është i ri.

Përparësia kryesore e metodës hedonike në ndërtimin e indekseve të çmimeve në krahasim me metodat konvencionale (të cilat bazohen në mbikëqyrjen e çmimit të të njëjtit produkt në kohë) është njohja e qartë e ndikimit të cilësisë në çmim. Kështu, indekset hedonike mundësojnë llogaritjen e ndryshimit të pastër të çmimit, respektivisht, ndryshim në çmim që nuk është rezultat i përmirësimit të produktit. Pikërisht për këtë arsye, këto indekse çmimesh zakonisht llogariten për produktet që ndryshojnë me shpejtësi - produkte të teknologjisë së lartë, kompjuterë, makina, por edhe apartamente.

¹ Metodologjia e përdorur është shpjeguar në detaje në Davidovska-Stojanova B., Jovanović B., Kadievski-Vojnoviq M., Ramadani G., dhe Petrovska M., (2008): Çmimet e patundshmërive në Republikën e Maqedonisë, Materialet punuese, BPRM.